



REPUBLIKA E KOSOVES · REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA



Planuar, Përfunduar dhe Data 08-10-2024			
Nr. Fiskal/Gj. Pr.	Numri i Pro.	Shtesa e Primit	Mbiza Vredësohet
02-	035/02	1178	



MEDICAL LABORATORY
AvicenaKS

MARRËVESHJE

PËR NDIHMË FINANCIARE PËR KOMUNËN E VITISË

E lidhur me datën 08.10.2024 në Komuna Viti në mes:

1. Komuna Viti, të cilën e përfaqëson Sokol Haliti, Kryetar i Komunës dhe
2. Laboratori "Avicena KS", shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me numër unik identifikues 810004755, me numër të regjistrimit të biznesit 810004755 dhe numër fiskal 810004755, me adresë të regjistruar në Rr.Radovan Zogovic Hyrja V,A5-L01, Arbëri, Prishtinë, përfaqësuar nga **Amar Shuki**, Drejtor Menaxhues, në tekstin e mëtejshëm referuar si Avicena KS

Përderisa, Avicena Ks ka bashkëpunim dhe mirëkuptim reciprok me Komunën e Vitisë dhe është e interesuar që tutje ta ndihmojë Komunën;

Përderisa, Komuna e Vitisë, bazuar në nevojat e saja, ka paraqitur kërkesë dhe interesim për ta ndihmuar Avicena Ks në aspektin financiar;

DUKE MARRË PARASYSH deklaratimet e dhëna më lart, të cilat janë pjesë përbërëse të kësaj Marrëveshje, Palët pajtohen si në vijim:

Neni 1

Objekti i Marrëveshjes

- 1.1. Objekti i kësaj Marrëveshje është ndihma financiare për Komunën Viti, e cila konsiston në pagesën e mëditjes mujore (çmimi i punës) për angazhim të një radiologu të punësuar nga punëdhënësi – Laboratori Avicena KS.
- 1.2. Lista e personave të angazhuar si në nenin 1. pika 1, është e caktuar nga autoritetet komunale.

Neni 2

Çmimi dhe mënyra e pagesës

2.1. Palët sipas kësaj Marrëveshje pajtohen për çmimin dhe mënyrën e pagesës së personave të angazhuar nga Laboratori Avicena KS, si vijon:

2.1.1. **Hamid Sahiti** - me nr. ID (letërnjoftimi) 1000951699, me profesion Radiolog nga Presheva dhe me vendbanim në Bregu I Diellit, Prishtinë, i angazhuar dhe i financuar nga Laboratori Avicena KS në lartësinë e shumës prej 200€. Pagesa do të procesohet në numrin e xhirollogarisë bankare: BPB 1300271100333203

Neni 3

Kohëzgjatja e Marrëveshjes

Pagesa për shërbimet e kryera, e cila do të bëhet në emër të Hamid Sahiti do të përfshijë periudhën kohore prej 08.10.2024 deri 06.11.2024, ku radiologu do të ofrojë shërbimet e tij në Komunën e Vitisë një herë në javë apo katër herë gjatë një muaji.

Neni 4

Vullneti i lirë

Palët deklarojnë dhe konfirmojnë se kjo Marrëveshje është lidhur në bazë të vullnetit të tyre të lirë dhe është e lirë nga çdo formë e detyrimit, qoftë fizik apo psikologjik, mashtrimi apo mungesë të informacionit dhe se Palët janë të vetëdijshme për pasojat ligjore që rrjedhin nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshje.

Neni 5

Konfidencialiteti

Palët do ta trajtojnë si konfidencialitet dhe nuk do të zbulojnë pa pëlqimin paraprak të palës tjetër asnjëlloj informate lidhur me lëndën e kësaj Marrëveshje.

Neni 6

Ligji qeverisës dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve

6.1. Palët pajtohen se kjo Marrëveshje, si dhe çfarëdo mosmarrëveshje që mund të burojë nga ajo do të qeveriset nga Ligjet e Republikës së Kosovës.

6.2. Çfarëdo mosmarrëveshje që del nga apo në lidhje me këtë Marrëveshje do të zgjidhet nga Gjykata me juridiksion kompetent në Republikën e Kosovës.

Neni 7

Ndryshimi

Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet vetëm në bazë të marrëveshjes me shkrim ndërmjet Palëve.

**Neni 8
Kopjet**

Kjo Marrëveshje është e përpiluar në tre kopje identike (Komuna Viti, Laboratori Avicena KS dhe Hamid Sahiti)

Palët kontraktuese:

Për dhe në emër të Komuna Viti

Emri dhe mbiemri: SOKOL HALITI

Pozita: KRYETAR I KOMUNES

Nënshkrimi dhe vula: 


Data: 08.10.2024



Për dhe në emër të Laboratori Avicena KS:

Emri dhe mbiemri: AMAR SHUKI

Pozita: Drejtor Menaxhues

Nënshkrimi dhe vula: 

Data: 8 tetor 2024